



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

APS.nr.2/2019

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS- Departamenti Special në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët, Ferit Osmani -Kryetari i kolegjit, Vaton Durguti dhe Milan Bigoviq-anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Leonita Lajçi, në çështjen penale ndaj të akuzuarve N.O. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, tani me vendbanim në Prishtinë, dhe B.SH. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje, Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, SH.LL. nga Peja, tani me vendbanim në Prishtinë, N.A. nga ..., tani me vendbanim në Prishtinë, M.Y. nga Gjakova dhe A.K. nga Mitrovica, tani me vendbanim në Fushë Kosovë, për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe A.D. nga fshati ..., Komuna e Podujevës, tani me vendbanim në Prishtinë, për shkak të veprave penale, Legalizimi i përmbajtjes së rremë në vazhdimësi, nga neni 403 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, veprës penale, Mashtrimi në vazhdimësi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, dhe veprës penale, Shmangie nga tatimi nga neni 249 par.2 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës PPS.nr.59/14 të datës 03.07.2019, të akuzuarit A.D.-av.A.K. dhe G.V., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.734/15 të datës 08.02.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPRK-së, më datë 30.12.2019, mori këtë:

AKTGJYKIM

I.Me aprovimin e ankesës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, e sipas detyrës zyrtare, përkitazi me të akuzuarit N.O., B.SH., SH.LL., N.A., M.Y., A.K. dhe A.D., **ANULOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 734/15 i datës 08.02.2019, për dispozitivin I, II. dhe III. pika 2, si dhe vendimi për refuzimin e kërkesës për konfiskim të pasurisë të evidentuar sipas urdhrit ndalues afatgjatë PKR.nr.218/14 të datës 30.06.2014, dhe çështja kthehet në RIGJYKIM.

II. Refuzohet ankesa e të akuzuarit A.D., si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr. 734/15 i datës 08.02.2019, për dispozitivin III pika 1 dhe 3 **VËRTETOHET**.

Ar sy e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Prishtinë, PKR.nr. PKR.nr. 734/15 i datës 08.02.2019, të akuzuarit N.O. nga fshati ..., Komuna e Lipjanit, tani me vendbanim në Prishtinë, dhe B.SH. nga Mitrovica, për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje, Keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, SH.LL. nga Peja, tani me vendbanim në Prishtinë, N.A. nga ..., tani me vendbanim në Prishtinë, M.Y. nga Gjakova dhe A.K. nga Mitrovica, tani me vendbanim në Fushë Kosovë, për shkak të veprës penale, në bashkëkryerje, Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe i akuzuari A.D. për veprën penale si në dispozitiv III pika 2, Legalizimi i përmbajtjes së remë në vazhdimësi nga neni 403 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, në kuptim të dispozitës së nenit 364 par.1 pika 1.3 të KPRK-së, janë liruar nga akuza, ndërsa i akuzuari A.D. për veprat penale si në dispozitiv III pika 1 dhe 3, gjegjësisht për veprat penale Mashtrimi në vazhdimësi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK-ës, dhe veprës penale Shmangie nga tatimi nga neni 249 par.2 të KPK-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim unik në kohëzgjatje prej 1 viti e 8 muaj, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 30.04.2014 e deri më 30.05.2014 dhe 30.05.2014 deri më 30.07.2014, si dhe dënimin me gjobë në shumë prej 10.000 euro, e cila do të paguhet në afat prej 15 ditësh e nëse e njëjta nuk paguhet do të zëvendësohet me dënim me burgim ashtu që për çdo ditë burgimi do t'i llogaritet nga 20 euro. Është obliguar që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 300 euro në afat prej 15 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. I pandehuri obligohet që palës së dëmtuar ATK-së, t'i kompensoj dëmin në shumë prej 53.807.46 euro, në afat prej 30 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit, ndërsa për pjesën tjetër e dëmtuara udhëzohet në kontest civil. Është refuzuar kërkesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës për konfiskimin e pasurisë të evidentuar sipas urdhrin ndalues afatgjatë të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.218/14 të datës 30.06.2014.

Në afat ligjor ankesë kanë paraqitur:

Prokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, për shkak të shkeljes esenciale të procedurës penale, vërtetimit jo të plotë dhe të gabueshëm të gjendjes faktike shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi sanksionin penalë me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovoj ankesën si të bazuar dhe aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe lëndën ta kthej në rishqyrtim dhe rivendosje.

Mbrojtësit e të akuzuarit A.D.-av.A.K. dhe G.V., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljet e ligjit material dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit në përputhje me nenin 398 par.1 pika 1.4 të KPPRK-së të ndryshoj aktgjykimin e ankimuar dhe të shpall aktgjykim refuzues respektivisht lirues për të akuzuarin A.D. apo në përputhje me nenin 398 par.1 pika 1.3 të anulon aktgjykimin e ankimuar dhe t'ia kthej gjykatës themelore për rigjykim dhe vendim.

Përgjigje në ankesën e PSRK-së, ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit N.O.-av.B.B., me kërkesë që Gjykata e Apelit të refuzoj si të pabazuar ankesën e PSRK-së për sa i përket pjesës liruese, të vërteton pjesën liruese të aktgjykimit të atakuar PKR.nr.734/15 të datës 08.02.2019.

Përgjigje në ankesën e PSRK-së, ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit SH.LL.-av.F.L., me propozim që Gjykata e Apelit të refuzoj si të pabazuar ankesën si të pabazuar.

Përgjigje në ankesën e PSRK-së, ka parashtruar mbrojtësja e të akuzuarës M.Y.-av.I.O.S., me propozim që Gjykata e Apelit të refuzoj si të pabazuar ankesën e PSRK-së dhe aktgjykimin PKR.nr.734/15 të datës 08.02.2019 me të cilin e akuzuar M.Y. lirohet nga akuza, t'a vërtetoj.

Prokuroria e Apelit të Kosovës në Prishtinë me shkresën PPA/I nr.387/19 të datës 10.09.2019, ka propozuar që ankesa e PSRK-së të aprovohet si e bazuar dhe aktgjykimin i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ndërsa të refuzohen ankesat e mbrojtësit e të akuzuarit A.D.-av.A.K. dhe G.V. dhe përgjigjet në ankesën e PSRK-së, SH.LL.-av.F.L., M.Y.-av.I.O.S. dhe N.O.-av.B.B., si të pabazuara.

Gjykata e Apelit mbajti seancën e kolegjit më datë 30.12.2019 konform dispozitës të nenit 390 par.1 të KPPRK-së, në të cilën ishin prezent përfaqësuesi i Administratës Tatimore të Kosovës, A.A., të akuzuarit M.Y., A.K., A.D., av.F.S., av.V.V., av.G.V., av.I.O.S. dhe av.F.L., ndërsa munguan Prokuroria e Apelit, përfaqësues nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, të akuzuarit N.O., B.SH. dhe av.B.B., të cilët janë njoftuar në mënyrë të rregullt mirëpo mungesën e tyre nuk e arsyetuan.

Në seancën e kolegjit përfaqësuesi i ATK-së- A.A. deklaroi se i bashkëngjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore-juridike, ndërsa mbrojtësi i të akuzuarit SH.LL.-av.F.L. mbeti pran pretendimeve dhe propozimit si në përgjigje në ankesë, mbrojtësi i të akuzuarit N.A.-av.F.S. ka propozuar që ankesa e PSRK-së të refuzohet si e pabazuar dhe aktgjykimin i ankimuar të vërtetohet, të cilin propozim e mbështeti edhe i akuzuari N.A., mbrojtësja e të akuzuarës M.Y.-av.I.O.S. mbeti pranë përgjigjes në ankesë duke shtuar se nuk është e nevojshme vetëm të paraqitet një ankesë dhe të përshkruhen dispozitat ligjore por mos të ceket asnjë provë siç ka ndodhur me rastin konkret në ankesë të PSRK-së, e të cilën e akuzuar M.Y. e mbështeti në tërësi mbrojtësen e saj av.I.O.S., mbrojtësi i të akuzuarit A.K.-av.V.M. theksoi se Prokurori i PSRK-së në ankesën nuk e ka përmend askund të mbrojturin e tij prandaj i njëjti nuk ka paraqitur përgjigje në ankesë por propozon që ankesa e PSRK-së të refuzohet si e pabazuar, e i akuzuari A.K. mbështeti fjalët e mbrojtësit të tij. Mbrojtësi i të akuzuarit A.D.-av.G.V. qëndroi pranë pretendimeve ankimore dhe theksoi se pjesa dënuese për të mbrojturin e tij përmban 10-11 rreshta dhe se dispozitivi është më i gjatë se arsyetimi i aktgjykimit e kjo paraqet një shkelje flagrante dhe se tërë arsyetimi është vetëm një kopy-past i deklaratave, pastaj shton se janë cekur dy datat por nuk është cekur periudha kohore kur është kryer veprimi inkriminues, bazohet në një faturë të "R..." sh.p.k se kinse nuk është ndërtuar depoja, por në fakt kjo depo është ndërtuar dhe është e funksionalizuar, duke shtuar më tutje se kjo është dëshmuar me deklaratat e M.A., E.R., dëshmitari S., V.R., dhe se "F..." sh.p.k nuk është pronë e AKP-së sepse e njëjta është blerë nga i mbrojturi i tij dhe se në këtë çështje nuk janë palë të dëmtuar as punëtorët e "F..." sh.p.k e as Buxheti i Kosovës si pretendon gjykata e shkallës së parë. Andaj, propozon që ndaj të mbrojturit të tij të merret aktgjykim lirues sepse kemi të bëjmë me parashkrim absolut. I akuzuari A.D. mbështeti mbrojtësin e tij dhe shton se është bërë edhe kontrolli tatimore dhe i njëjti s'ka kryer veprë penale dhe për këtë propozon që të lirohet nga akuza.

Gjykata e Apelit, analizoi dhe vlerësoi aktgjykimin e ankimuar si dhe pretendimet ankimore, të cilat i vlerësoi konform dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPRK-së dhe pas vlerësimit të pretendimeve të theksuar në ankesë, përgjigjeve në ankesë dhe mendimin e Prokurorisë së Apelit, gjeti se:

Ankesa e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës është e bazuar ndërsa ankesa e përbashkët e mbrojtësve e të akuzuarit A.D.-av.A.K. dhe G.V. është e pabazuar.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës përkitazi me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale.

Prokuroja e PSRK-së në ankesë pretendon se me aktgjykimin e ankimuar është bërë shkelja esenciale e dispozitave penale sepse arsyetimi i aktgjykimit për të gjithë të akuzuarit e liruar nga akuza është në kundërtënie të plotë me dispozitivin e aktgjykimit nën 1 për të akuzuarit N.O. dhe B.SH., nën 2 për të akuzuarit SH.LL., N.A., M.Y. dhe A.K. dhe nën 3 për të akuzuarin A.D., në këtë rast gjykata vetëm ka konstatuar kontestueshmërin e veprimeve penale pa asnjë arsyetim. Gjykata e shkallës së parë ka përmendur disa nga provat e administruara me të cilat janë vërtetuar veprimet inkriminuese të personave zyrtar të AKP-së, por të njëjtëve nuk ua ka kushtuar vëmendjen e duhur, duke theksuar më tutje në ankesë më tepër për sa i përket gjendjes së fakteve me pretendim se gjykata nuk ka arritur të vërtetoj në mënyrë të drejtë dhe të plotë gjendjen faktike përkundër faktit se nga shumë prova të administruara në mënyrë të qartë dhe të plotë është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në aktakuzë.

Mbrojtësit e të akuzuarit A.D.-av.A.K. dhe G.V. në ankesën e tyre të përbashkët pretendojnë se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPRK-së lidhur me pikën 1 të aktgjykimit dënues, për shkak se dispozitivi është i pakuptueshëm, i paqartë dhe në kundërshtim me arsyetimin dhe faktet vendimtare të paraqitura nga gjykata e shkallës së parë. Më tej përshkruan dispozitat e nenit 370 par.6 dhe 7 të KPP-së, duke theksuar se aktgjykimi është përshkruar me shumë paqartësi dhe me pasaktësi nga të cilat nuk kuptohet se cili është saktësisht veprimi inkriminues i të pandehurit A.D. në të cilat janë konstituuar elementet e veprës penale për të cilën edhe dënohet. Për veprën penale përcaktimi i saktë i momentit të kryerjes së veprës penale është rrethanë me rëndësi primare lidhur me gjendjen faktike, e sidomos për aplikimin e drejtë të dispozitave mbi parashkrimin e veprës penale dhe kodit jonë penal ka adaptuar parimin se vepra penale kryhet në momentin kur personi ka vepruar. Më tutje, në ankesë elaboron nenin 81 të KPRK-së, duke theksuar se aktgjykimi ka dështuar me identifikimin e veprimeve inkriminuese dhe përcaktimin e kohës së saktë të kryerjes së tyre. Thekson se gjykata si veprime inkriminuese i trajton dy situata konkrete dhe atë se i pandehuri A.D. ka paraqitur fatura të rreme dhe fiktive për faktin se ka pasur një kontratë ndërtimi me Kompaninë R... sh.p.k, ndërsa ndërtimi nuk është realizuar dhe përkundër kësaj i pandehuri e ka paraqitur se investimi në AKP të njëjtën faturë dhe se i pandehuri ka paraqitur si investim blerjen e një rimorkio/kamioni nga ana e dëshmitarit D.Z., i cili sipas pretendimit të gjykatës, ky kamion/rimorkio nuk kanë qenë pronë e dëshmitarit D.Z., por atë e ka thirr vëllau i të pandehurit që të bëjë kontratë të shitblerjes së këtij kamioni/rimorkio. Mbrojtja në ankesë thekson se veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale e cila konsiston në pretendimin se është paraqitur fatura e rreme me përshkrim “ndërtimi i depos në Podujevë” ka ndodhur me datën 01.06.2009. Veprimi tjetër i kryerjes së kësaj vepre penale e cila konsiston në pretendimin se janë paraqitur në mënyrë të rreme blerja e kamionit/rimorkios, ka ndodhur me datën 26.04.2007. Andaj, këto dy veprime i janë nënshtruar dispozitave materiale lidhur me parashkrimin absolut. Më tutje në ankesë pretendojnë se sipas arsyetimit gjykata thekson se gjatë shqyrtimit të provave ka vërtetuar faktet nga deklarami i dëshmitarit S. R... se ka ekzistuar një kontratë për ndërtimin e një objekti (depo) ndërmjet firmës së tyre nga ndërmarrja F... mirëpo ky ndërtim nuk është realizuar pasi që atë punë e ka kryer ndërmarrja F... me anë të punëtorëve të saj, nga ky fakt vërteton gjykata se i pandehuri ka paraqitur dokument për përmbushjen e detyrimeve dhe përfitim të tij pasur duke mashtruar organet kompetente në AKM-së lidhur me këtë çështje se të njëjtat i ka paraqitur si investime kapitale dhe në këtë drejtim mbrojtja thekson se gjykata nuk merr fare parasysh faktin se në mes të ndërmarrjes F... dhe R... sh.p.k ka pasur një kontratë për ndërtimin e depos, ka pasur transaksionet bankare me përshkrim të qartë “pagesë për ndërtimin e depos”, ka pasur faturë të rregullt të lëshuar nga ana e R... sh.p.k për F... sh.p.k. me të cilën faturë kompania R... sh.p.k është ngarkuar me TVSH, si dhe përfundimisht nuk merr parasysh faktin se objekti është i ndërtuar dhe i njëjti ekziston, dhe nga deklaratat e E.R. dhe RR. S., vërtetohet se depo është ndërtuar dhe

funksionalizuar, janë futur vegla, pajisje bujqësore dhe të tjera çka ka pasur nevojë. Tutje në ankesë mbrojtja paraqet edhe faturat për pagesë e realizuara ndërmjet R... sh.p.k dhe F..., dhe atë fatura nr. 3 e datës 325,570, 00 euro, pagesa e datës 31.07.2009 në vlerë prej 102,150.00 me përshkrim “pagesa për F... sh.p.k Podujevë për R... sh.p.k për ndërtimin e depos së mallrave, pagesa e datës 06.06.2009 nga llogaria rrjedhëse e F... sh.p.k për R... sh.p.k në vlerë prej 18,000.00euro me përshkrim “transfer nga F... sh.p.k për R... sh.p.k”, pagesa e datës 07.06.2009 nga llogaria rrjedhëse e F... sh.p.k për R... sh.p.k në vlerë prej 1.000.00 euro me përshkrim “Trasfer nga F... sh.p.k për R... sh.p.k, pagesa e datës 21.08.2009 nga llogaria rrjedhëse e F... sh.p.k për R... sh.p.k në vlerën prej 50,000.00 euro me përshkrim “F.../R... sh.p.k pagesë për ndërtimin e objektit. Përveç pagesave kesh ashtu siç vërtetohet edhe nga dëshmitarja V.R. në deklaratën e saj të dhënë pranë Administratës Tatimore të Kosovës, e cila është lexuar në shqyrtimin gjyqësor kompensimin për ndërtimin e depos është bërë edhe nëpërmjet ndërrimit të mallit. Po ashtu përveç që ka pasur kontratë në mes të kompanisë F... sh.p.k dhe D.Z. për blerjen e kamionit dhe rimorkios të njëjtat janë regjistruar në emër të kompanisë F... sh.p.k dhe pas blerjes së tyre ato janë përdorur në procesin e punës. Dëshmitari D. nuk e përmend askund A.D.n, ai thotë se A.D. ka qenë ai i cili kinse e ka shtyer të bëjë këtë kontratë. Si i tillë ky veprim nuk mund t’i atribuohet të pandehurit D., ai thekson se këtë e ka bërë E. D.. Mbrojtja në ankesë thekson se dëshmitari M.A., i cili ishte person përgjegjës në realizimin e auditimit nga Kompania G... për kompanin F... sh.p.k në dëshminë e tij deklaroi se asnjë faturë e verifikuar nga ana e tyre nuk ishte e falsifikuar apo fiktive për faktin se të gjitha faturat përveç se janë verifikuar se të njëjtat ekzistojnë si dokumentacion është verifikuar se blerjet që figurojnë në fatura janë edhe fizikisht në ndërmarrje. Më tutje në ankesë theksohet se gjykata nuk e ka arsyetuar fare se i pandehuri D. i ka vënë në lajthim zyrtarët e AKP-së dhe janë shtytur që të veprojnë në dëm të pasurisë së AKP-së, punëtorëve të ndërmarrjes së re F... sh.p.k. Ky pretendim është tërësisht i pabazuar pasi A.D. ishte blerës i ligjshëm i ndërmarrjes F... dhe si tillë pronësia e ndërmarrjes kishte kaluar mbi të e fakti se kishte disa kufizime në gëzimin e plotë të të drejtave pronësore, assesi nuk mund të pretendohet se prona nuk ishte e tij e kjo dëshmohet edhe me certifikatën mbi pronësinë në të cilën shihet se ai figuron si pronar (qirambajtës për 99 vjet sipas ligjit të AKP-së). Në aktgjykim pjesa arsyetuese është fare e heshtur për pjesën ku i pandehuri është shpallur fajtor për shkak se e ka futur kolateralin-hipotekën e ndërmarrjes F...-Podujevë lidhur me përmbushjen e borxhit ndaj kreditorit R... në shumën prej 2.607.000 euro për periudhën 2008-2011. Më tutje në ankesë mbrojtja thekson se gjykata nuk e adreson fare se si ka ardhur deri te shuma prej 5.400.000 euro që i pandehuri ka përfituar duke e futur në hipotekë pronën që nuk ka qenë e tij duke rrezikuar në këtë formë pronën e AKP-së, kështu që i ka sjellë dobi pasurore në këtë vlerë. Mbi bazën e të gjitha të theksuara më lartë mbrojtja pretendon se aktgjykimi për pikën 1 është përfshirë me shkelje esenciale të nenit 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPRK-së.

Po ashtu mbrojtja në ankesë thekson se aktgjykimi në pikën 2 është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 lidhur me nenin 370 par.6 dhe 7 të KPPRK-së. Në pjesën arsyetuese gjykata i referohet raportit të ATK-së dhe pa e analizuar atë raport/ndërlidhur me provat tjera ka bërë shkelje të dispozitave të KPP-së, ka bërë që gjykata të vijë në përfundim tërësisht të gabuar. Gjykata ka adoptuar qëndrimin e ATK-së i cili pretendon se i tërë transaksioni me kompaninë R... sh.p.k fare nuk ka ndodhur dhe se i njëjti është në tersi fiktiv. Gjykata fare nuk merr parasysh faktin se në mes të ndërmarrjes F... dhe R... sh.p.k ka pasur kontratë për ndërtimin e depos dhe ka pasur transaksionet bankare me përshkrimet të qarta “ pagesë për ndërtimin e depos”, ka pasur fatura të rregullt të lëshuar nga ana e R... sh.p.k për F... sh.p.k me të cilën faturë kompania R... sh.p.k është ngarkuar me TVSH, si dhe përfundimisht nuk merr parasysh faktin se objekti është i ndërtuar dhe i njëjti ekziston.

Mbrojta në ankesë thekson se ka shkelje të ligjit penal, duke theksuar nenin 81 të KPK-së, me çka gjykata dështon në mënyrë të qartë në aktgjykim për të identifikuar veprimet inkriminuese dhe përcaktimin e kohës së saktë të kryerjes së tyre, gjykata lidhur me kohën e kryerjes së veprës penale në mënyrë fjalëpërfjalshme vetëm e citon dispozitivin dhe dështon të përcaktoj kohën e kryerjes së këtyre veprimeve. Në këtë mënyrë periudha 2006-2012 gjatë së cilës pretendohet se janë kryer këto veprime është një konstruksion i zbrazët dhe i pabazuar në asnjë provë. Më tutje thekson se bazuar në nenin 106 të KPK-së, afati i parashkrimit fillon nga dita kur është kryer vepra penale, duke pasur parasysh se veprimi i kryerjes së këtyre veprave të pretenduara është data 26.04.2007 dhe 01.06.2009 për të dy këto vepra penale në përputhje me nenin 107 par.8 i KPK-së ka arritur dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit(i cili është 5 vjet), andaj është arritur afati absolut i parashkrimit.

Në ankesë për pretendimin e vërtetimit të gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike, mbrojtja thekson se gjykata duke i vlerësuar provat në mënyrë të gabuar ashtu siç u elaboruan në sipër ka bërë edhe vërtetim të gabuar të gjendjes faktike. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike konsiston posaçërisht në faktin se gjykata e trajton ndërtimin e depos dhe faturën e lëshuar nga R... sh.p.k si të paqena dhe në këtë mënyrë e paraqet këtë faturë si fiktive dhe njëjtë qëndron edhe situata me blerjen e kamionit dhe rimorkios nga ana e D. Z. pra ato janë regjistruar në emër të kompanisë F... sh.p.k dhe është paradoksale të theksohet se ky transaksion nuk ka ndodhur.

Gjykata e Apelit, pasi analizoi dhe vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në drejtim të pretendimeve ankimore, gjeti se pretendimet e PSRK-së, janë të bazuara meqenëse aktgjykimi i ankimuar në pjesë liruese për dispozitivin I, II dhe III pika 2 të aktgjykimit, është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të parashikuara në nenin 384 të KPPRK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset edhe sipas detyrës zyrtare, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i paqartë dhe i pakuptueshëm ndërsa në arsyetim nuk ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të qarta lidhur me faktet vendimtare të cilat i ka vërtetuar apo nuk i ka vërtetuar si dhe arsyet në të cilat është bazuar në rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike dhe përgjegjësisë penale e të akuzuarve.

Gjykata e Apelit gjen se është i bazuar pretendimi ankimor i PSRK-së, për pjesën liruese, për dispozitivin I, II dhe III pika 2 të aktgjykimit të ankimuar kjo pasi që, me të drejtë Prokurorja e PSRK-së, në ankesë thekson se aktgjykimi i ankimuar vetëm ka konstatuar kontestueshmërin e veprimeve penale pa asnjë arsyetim, andaj kjo Gjykatë gjen se si i tillë është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 e lidhur me nenin 370 par. 7 dhe nenin 361 të KPPRK-së meqenëse gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar në pjesën liruese nuk ka dhënë asnjë arsye se cilat fakte dhe për çfarë arsye i ka konsideruar si të vërtetuara apo të pavërtetuara. Arsyetimi i aktgjykimit për pjesën liruese është përfshirë me përshkrim të deklaratave të akuzuarve, mbrojtësve të tyre dhe dëshmitarëve të dhënë në shqyrtimet gjyqësore pa ndonjë analizë dhe vlerësim të tyre por vetëm me çështjet e ngritura edhe nga vetë gjykata e shkallës së parë lidhur me çështjet kontestuese duke përshkruar më pas veprimet inkriminuese e të akuzuarve dhe përshkrimin e veprës penale nga neni 422 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke konstatuar se gjykata gjatë administrimit të provave në këtë çështje penale, nuk ka arritur të vërtetoi faktin se në veprimet e të pandehurve nuk janë përmbushur elementet e veprës penale “Keqpërdorimi i detyrës apo autoriteti zyrtarë” nga neni 422 par.1 të KPRK-së. Ndërsa për dispozitivin III pika 2 ka konsideruar se veprimi i kryerjes është ndërmarr në dokumentin privat-faktura fiktive që më tepër konsumohen elementet e veprës penale të mashtrimit se sa të legalizimit të përmbajtjes së remë ndërsa nga arsyetimi rrjedh që nuk ka arritur të vërtetoj se në veprimet e të akuzuarit, nuk janë konsumuar elementet e veprës penale nga neni 403 par.2 lidhur me par. 1 të KPRK-së. Andaj, në këtë drejtim arsyetimi nuk është i qartë dhe i kuptueshëm a është liruar në mungesë provash për veprën

penale për të cilën është liruar nga akuza apo se këto veprime konsumohen në veprën penale të mashtrimit.

Sa i përket refuzimit për konfiskimin e pasurisë të evidentuar sipas urdhrit ndalues afatgjatë PPR.KR.218/14 të datës 30.06.2014 kjo gjykatë gjen se, arsyetimi për këtë propozim të PSRK-së, me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë rrjedh të jetë vendosur dhe arsyetuar jo tërësisht lidhur me këtë urdhër ndalues afatgjatë pasi që është arsyetuar vetëm me faktin se personi i tretë (R...) nëpërmjet procedurës përmbarimore përmes titullit përmbarimor, aktvendimin për hipotekë ka bartur pasurinë e F... Sh.p.k nga debitori të cilën e ka përfaqësuar A.D., këtu kreditorit R.... Mirëpo, kjo Gjykatë vëren se me këtë urdhër ndalues janë përfshirë edhe shumë asetet-mjetet sendet që janë përfshirë me këtë urdhër ndalues andaj është e paqartë se çfarë është vendosur lidhur me këto asete. Andaj, në këtë drejtim kjo Gjykatë gjen se gjykata nuk ka dhënë arsye të plota dhe të mjaftueshme lidhur me refuzimin e kërkesë së PSRK-së për konfiskimin e aseteve sipas këtij urdhri ndalues. Gjykata e Apelit, vlerëson se gjykata e shkallës së parë është dashur të jep arsye nëse këto asete tjera sipas këtij urdhri ndalues janë liruar dhe nëse po kujt është dashur që ti dorëzohen-kthehen, ashtu si përcakton edhe dispozita e nenit 248 të KPPRK-së.

Gjykata e Apelit gjen se gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar është dashur që vlerësoj secilën provë një nga një dhe në lidhje me provat e tjera (provat materiale të procedura në shqyrtim gjyqësorë), dhe në bazë të vlerësimit të tillë të nxjerrë përfundim nëse fakti konkret është provuar e jo vetëm që me formulim të përgjithësuar të konstatoj se gjykata nuk ka arritur të vërtetoi faktin se në veprimet e të pandehurve nuk përbushen elementet e veprës penale. Andaj, si tillë aktgjykimi i ankimuar për pjesën liruese është përfshirë me shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 dhe si i tillë për këtë pjesë aktgjykimi detyrimisht është dashur që të anulohet dhe të kthehet në rigjykim.

Gjykata e Apelit, pasi analizoi dhe vlerësoi aktgjykimin e ankimuar në drejtim të pretendimeve ankimore e mbrojtësve e të akuzuarit A.D.-av.A.K. dhe G.V., gjeti se pretendimet e tyre janë të pabazuara meqenëse aktgjykimi i ankimuar në pjesë fajsuere për dispozitivin III pika 1 dhe 3 të aktgjykimit, nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të paraparë në nenin 384 të KPPRK-së, për të cilat kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, pasi që dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar është i qartë dhe i kuptueshëm ndërsa në arsyetim ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të qarta lidhur me faktet vendimtare të cilat i ka vërtetuar si dhe arsyet në të cilat është bazuar në rastin e zgjidhjes së kësaj çështje juridike dhe përgjegjësisë penale e të akuzuarit.

Gjykata e Apelit gjen si të pabazuar pretendimin ankimor të mbrojtësve e të akuzuarit A.D. lidhur me përcaktimin e saktë të momentit të kryerjes së veprës penale pasi që gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar të dispozitivit III pika 1 ka përshkruar veprimet inkriminuese të të akuzuarit që i ka ndërmarrë në periudhë kohore në kryerje të veprës penale të mashtrimit në vazhdimësi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPKsë , që nga 23.06.2006 e deri më 20.01.2012 dhe atë pikërisht për ti sjell në lajthim zyrtarët e AKM/AKP me anë të paraqitjeve të rreme apo duke i fshehur faktet me qëllim që të sjellë përfitim për vete e në dëm të AKM/AKP-së. Kjo për faktin se kjo vepër penale në vazhdimësi në konstruksionin e saj kërkon që të jetë kryer brenda një periudhe të caktuar kohore, gjegjësisht që të ekzistojë kontinuiteti kohor, e jo domosdoshmërisht do të duhej të caktohej secili veprim konkret, me shumë veprime shkaktohen shumë pasoja të cilat shikuar veç e veç paraqesin vepra penale të veçanta, andaj duke marrë parasysh se në rastin konkret i akuzuari brenda kësaj periudhe kohore të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit në mënyrë të vazhdueshme ka kryer këto dy vepra penale të mashtrimit, duke i paraqitur në vazhdimësi këto fatura – kontratat fiktive pranë

organeve të AKM/AKP-së, për qëllimet e mashtrimit të tyre dhe të njëjtit të veprojnë në dëm të AKP-së.

Në fakt, në nenin 81 të KPK-së, ashtu si edhe e citon në ankesë vetë mbrojtja, kjo Gjykatë gjen se përmbushen të gjitha elementet ligjore për ekzistimin e veprës penale të kryer në vazhdimësi, meqenëse, ashtu si edhe gjykata e shkallë së parë, në aktgjykimin e ankimuar i përshkruan veprimet inkriminuese më afër si në dispozitiv III pika 1 të aktgjykimit, këtë gjetje/përshkrim të veprimeve inkriminuese e pranon edhe kjo Gjykatë si të drejtë, pasi që në rastin konkret kemi të bëjmë me dy e më shumë vepra penale, të njëjta gjegjësisht llojit të njëjtë, që i njëjti i akuzuar ti ketë kryer dhe të gjitha këto vepra janë kryer ndaj të njëjtit person – objekt mbrojtës dhe brenda një periudhe të caktuar kohore si dhe të jenë kryer me dashje dhe për këtë gjykata e shkallë së parë ka dhënë arsyetim të mjaftueshëm e të paraqitur si në faqen 80-81 të aktgjykimit, duke dhënë edhe arsye se me cilat provat dhe për çfarë arsye i ka vërtetuar këtë fakte.

Gjykata e Apelit gjen si të pabazuar pretendimin e mbrojtjes se, gjykatës së shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar nuk ka cekur kohën e kryerjes së veprimeve inkriminuese. Në fakt, kjo Gjykatë gjen se gjykata e shkallës së parë aktgjykimin e ka bazuar pikërisht në provat të cilat edhe i ka proceduar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Në rastin konkret, ashtu si e paraqet mbrojtja se gjykata e shkallës së parë nuk i ka paraqitur datat e veprimeve inkriminuese përkatësisht faturat e rreme dhe fiktive, kjo për faktin se nga arsyetimi i aktgjykimit të ankimuar rrjedh se gjykata këtë gjendje të përshkruar si në dispozitiv e ka bazuar pikërisht në dëshminë e dëshmitarit S. R... lidhur me kontratën për ndërtimin e një objekti ndërmjet firmës së tyre “R...” sh.p.k dhe ndërmarrjes “F...” Podujevë, i cili ndërtim nuk ishte realizuar, pasi që punimet i kishte kryer vet ndërmarrja “F...” me punëtorët e tyre dhe nga ky fakt gjykata ka vërtetuar se paraqitja e këtij dokumenti – fature për përmbushjen e detyrimit dhe paraqitjen e të njëjtit si investim kapital, është e rreme – fiktive. Po ashtu, edhe sa i përket faktit tjetër gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar e ka bazuar edhe nga dëshmia e dëshmitarit D. Z., i cili në shqyrtimin gjyqësor ka vërtetuar faktin se ai ka nënshkruar kontratën e shitblerjes së rimorkios dhe kamionit me E. D.n, gjegjësisht vëllain e të akuzuarit A.D., mirëpo edhe përkundër këtij pretendimi të paraqitur nga mbrojtja se në këtë rast i akuzuari A.D. nuk ishte nënshkruar i kësaj kontrate, kjo Gjykatë gjen se kontratat në fjalë, për këtë rimorkio dhe kamionit janë nënshkruar për emër dhe për interesat e ndërmarrjes “F...” sh.p.k., e cila ndërmarrje me kontratën mbi privatizimin ndërmjet AKM/AKP dhe të akuzuarit A.D. ishte nënshkruar për periudhën kohore prej datës 23.03.2006 deri me 23.03.2008 në periudhën e monitorimit nga AKM/AKP. Prandaj kjo Gjykatë gjen se nuk qëndron pretendimi se në aktgjykimin e ankimuar nuk janë detajizuar këto fakte.

Gjykata e Apelit gjen se është i pabazuar pretendimi ankimor i mbrojtësve e të akuzuarit se në rastin konkret, duke marrë parasysh që veprimi i kryerjes së veprës penale në pretendim se është paraqitur faturë e rreme me përshkrimin “Ndërtimi i depos në Podujevë”, ka ndodhur me datën 01.06.2009 dhe veprimi tjetër i kryerjes së kësaj veprës penale e cila konsiston se është paraqitur në mënyrë të rreme blerja e kamionit / rimorkios ka ndodhur me datën 26.04.2007, për faktin se kjo Gjykatë gjen se në rastin konkret këto dy data janë veprimet të cilat i akuzuari A.D. i ka ndërmarrë në vazhdimësi për të siguruar këto dy fatura/kontrata dhe për t’i paraqitur organeve të AKM/AKP-së me qëllim të mashtrimit të tyre. Andaj, në këtë çështje penale objekt i akuzës gjegjësisht i aktgjykimit është vepra penale e mashtrimit në vazhdimësi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, për të cilën i akuzuari A.D. është shpallur fajtor. Prandaj, pretendimi i mbrojtjes se këto data gjegjësisht veprimi i parë me datë 26.04.2007 dhe veprimi i dytë 01.06.2009, e që në fakt nga shkresat e lëndës respektivisht kontrata mbi ndërtimin e depos figuron data 18 maj 2009, nuk janë datat kur është paraqitur veprimi i të akuzuarit për veprën penale të mashtrimit në vazhdimësi, por është veprimi kur i akuzuari ka paraqitur këto dy fatura, pra për kamionin dhe rimorkion në raportimin e 3 mujorit të

pestë për periudhën 01.04 e deri me 30.06.2007, pranë Njësitit të monitorimit të AKM si investime kapitale dhe nga kjo veprë penale e mashtrimit si dokument fiktiv i akuzuari më pas kontratën për ndërtimin e depos në Podujevë të përpiluar me datën 18 maj 2009 ndërmjet “R...” sh.p.k dhe “F...” sh.p.k., e ka paraqitur me datë 06.04.2010 për pranimin e investimeve kapitale, çka do të thotë se këto dy vepra penale të mashtrimit nëpërmjet këtyre dy faturave – kontratave janë paraqitur në vazhdimësi dhe që gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar drejtë ka vepruar kur ka gjetur se në veprimet e të akuzuarit janë formuar elementet e veprës penale të mashtrimit në vazhdimësi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së.

Duke marrë për bazë dispozitën e nenit 9 të Kodit Penal ku parasheh se vepra penale kryhet në kohën kur kryerësi ka vepruar apo ka qenë i detyruar të veprojë pa marrë parasysh kohën kur është shkaktuar pasoja, kjo Gjykatë gjen se nga shkresat e lëndës rezulton që veprimi kryerës i të akuzuarit A.D. në drejtim të paraqitjes së këtyre faturave të rreme në drejtim të organeve të AKM/AKP, për të paraqitur këto fatura si faktet e rreme – fiktive, është pikërisht data 06.04.2010, e që rezulton nga shkresat e lëndës për konfirmimin e pranimit të rregullt të paraqitur nga ana e të akuzuarit A.D. e të pranuar nga zyrtari i AKP-së, N.I., gjë që vërtetohet me nënshkrimin e tyre, pjesë e shkresave të lëndës, nëpërmjet së cilës i akuzuari A.D. ka paraqitur raportin për pranimin e investimeve kapitale për periudhën prej momentit të përfundimit të auditimit të brendshëm e deri në kohën e paraqitjes. Pra, Gjykata e Apelit gjen se veprimi i fundit i kryerjes së veprës penale nga i akuzuari A.D. është pikërisht raportimi për investimet kapitale me datën 06.04.2010, kur i njëjti ka paraqitur këto fatura për pranimin e investimeve në mesin e të cilave edhe kontratën për ndërtimin e depos me ndërmarrjen “R...” sh.p.k. me vlerë të përgjithshme prej 326.570,00 euro, e cila kontratë gjatë shqyrtimit gjyqësor e nga dëgjimi i dëshmitarëve S. R... është konfirmuar se edhe përkundër ekzistimit të kësaj kontrate ndërmjet firmës së tyre dhe ndërmarrjes “F...”, ky ndërtim nuk është realizuar pasi që atë punë e ka kryer ndërmarrja “F...” me anë të punëtorëve të saj, ndërkaq në raportin për pranimin e investimeve kapitale, i pandehuri të ketë paraqitur si kontratë për ndërtim në shumë të përgjithshme prej 326.570,00 euro.

Andaj, Gjykata e Apelit gjen se pretendimi i mbrojtjes se datat e kryerjes së veprave penale nga ana e të akuzuarit A.D., në momentin e nënshkrimit të këtyre dy kontratave, respektivisht për shitblerjen e kamionit dhe rimorkios me datë 26.04.2007 dhe kontratës për ndërtimin e depos me datë 01.06.2009 është i pabazuar për faktin se vepra penale e mashtrimit gjegjësisht veprimi i fundit inkriminues nga i akuzuari A.D., është pikërisht data e dorëzimit të konfirmimit të raportit të rregullt për investimet kapitale, gjë që në rastin konkret duke marrë parasysh se që nga veprimi i parë i ndërmarrë nga ana e të akuzuarit e deri në kohën kur i akuzuari i ka paraqitur këto fakte para organeve kompetente të AKM/AKP, është pikërisht veprimi i ndërmarrë gjegjësisht momenti i paraqitjes së këtyre fakteve të rreme – fiktive për pranim të investimeve me datë 06.04.2010 dhe që nga kjo kohë duke marrë parasysh afatet ligjore për parashkrimin e kësaj vepre penale, gjegjësisht nenit 106 të KPK-së, ku parashihet që vepra penale për të cilën është paraparë me shumë se 3 vite burgim, afati i parashkrimit është 5 vite, e që parashkrimi absolut është dyfishi i kohës së paraparë së afatit për parashkrim dhe marrë parasysh se koha e kryerjes së veprës penale gjegjësisht momenti kur i akuzuari ka ndërmarrë veprimin për të kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, është data 06.04.2010 në këtë çështje penale nuk ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale.

Gjykata e Apelit gjen si të pabazuar pretendimin e mbrojtjes se gjykata e shkallës së parë fare nuk ka marrë për bazë faktin se duke marrë parasysh ekzistimin e kontratës për ndërtimin e depos sipas të cilave ka pasur transaksion bankar me përkrim të qartë “Pagesa për ndërtimin e depos” me fatura të rregullta të lëshuar nga “R...” sh.p.k. për “F...”, me të cilën faturë kompania “R...” është e ngarkuar me TVSH dhe objekti është i ndërtuar dhe i njëjti ekziston, ky pretendim nuk ishte kontestues në drejtimin e ekzistimit apo të mos ekzistimit të objektit – depos të ndërtuar, por për këtë ndërtim i

akuzuari ka paraqitur një faturë të rreme – fiktive, se gjëja është realizuar investimi kapital përndërtimin e depos nga ana e ndërmarrjes “R...” sh.p.k., dhe nga vet provat në shkresat e lëndës ashtu siç janë paraqitur edhe nga vet mbrojtja në ankesën e tyre edhe përkundër listimit të faturave – pagesave nga llogaria rrjedhëse e “F...” sh.p.k. për “R...”, nuk rezultojnë që të jetë kryer transaksioni i përgjithshëm në shumën e paraqitur si në faturën nr.3 me shumë të përgjithshme prej 326.570,00 euro.

Është i pabazuar pretendimi i mbrojtjes se nëse shikohen provat e administruara vërtetohet se ka pasur kontratë në mes të kompanisë “F...” sh.p.k dhe D.Z. për blerjen e kamionit dhe rimorkios, e të cilat janë regjistruar në emër të kompanisë “F...” sh.p.k., për faktin se bazuar në dëshminë e D.Z.t në shqyrtimin gjyqësor, vërtetohet fakti se ai nuk ishte pronar i këtij kamioni dhe rimorkio, e që kishte për të ia shitur ato kompanisë “F...”, mirëpo këto kontratat si të tilla janë përdorur dhe janë paraqitur në mënyrë fiktive dhe të rreme mu para organeve të AKM/AKP, si investime kapitale për përmbushjen e detyrimeve nga i akuzuari A.D. sipas kontratës së privatizimit për këtë ndërmarrje, andaj në këtë çështje nuk është kontestuar ekzistimi i këtyre kontratave, por në fakt është çështje e paraqitjes së këtyre kontratave përpara organeve të AKM/AKP, si të rreme – fiktive, pra që në realitet fare nuk ka ndodhur çështja e shitblerjes së tyre, por është paraqitur vetëm në këtë raport si dokument – kontratë dhe faturë, për qëllimet e paraqitjes së tyre kinse për investimet kapitale pranë AKM/AKP, edhe përkundër asaj që mbrojtja pretendon se nga dëshmitari M.A., i cili ishte person përgjegjës në realizimin e auditimit nga ana e kompanisë “G...”, për kompaninë “F...”, që në dëshminë e tij ka deklaruar se asnjë faturë e verifikuar nga ana e tyre nuk ishte e falsifikuar, apo fiktive, pasi që përveç se janë verifikuar të gjitha faturat, që të njëjtat ekzistojnë si dokumentacion, është verifikuar se blerjet që figurojnë në fatura janë edhe fizikisht në ndërmarrje, mirëpo nga vet dëshmitari D. Z. është pohuar që këto kontratat realisht janë fiktive edhe si të tilla të rreme, e të cilat i akuzuari A.D. ka pasur për qëllim që t’i paraqesë si investime kapitale.

Pretendimi i mbrojtjes lidhur me mos arsyetimin se zyrtarët e AKP-së janë vënë në lajthim dhe janë shtytur që të veprojnë në dëm të pasurisë së AKP-së punëtorëve të ndërmarrjes së re “F...” sh.p.k si dhe në dëm të buxhetit dhe ekonomisë së vendit, Gjykata e Apelit gjen se ky pretendim i mbrojtjes është i pabazuar për faktin se vet çështja e liritimit nga AKM/AKP të monitorimit të ndërmarrjes “F...” sipas Spin Off-it special, nëpërmjet paraqitjes së rreme dhe fiktive të investimeve kapitale arsyeton vet faktin se nëpërmjet këtyre veprimeve të mashtrimit me qëllim të përfitimit dhe liritimit nga mbikëqyrja nga ana e AKM/AKP-së, rezultojnë se nga ky lajthim në të cilën janë sjellë zyrtarët e AKP-së, i pandehuri A.D. i ka shtytur pikërisht të njëjtat që të veprojnë në dëm të AKP-së dhe punëtorëve të kësaj ndërmarrjeje dhe në dëm të buxhetit të shtetit.

Gjykata e Apelit gjen se është i pabazuar pretendimi i mbrojtjes për mosparaqitjen e arsyeve lidhur me atë se i pandehuri ka futur në kolateral – hipotekë ndërmarrjen “F...” lidhur me përmbushjen e borxhit ndaj kreditorit R... në shumë prej 2.607.000 euro për periudhën 2009 – 2011, meqenëse edhe nga vet mbrojtja e të akuzuarit gjykata e shkallës së parë ka arsyetuar se mbrojtja e të pandehurit nuk ishte në përputhje me provat e administruara dhe qëllimi i tij ishte ikja nga përgjegjësia penale, dhe kjo Gjykatë duke marrë për bazë mos mohimin e vënies në hipotekë të kësaj ndërmarrjeje nga ana e vet të pandehurit pa pëlqimin e AKP-së, rezultojnë që ky fakt të mos jetë kontestuar, por që një mbrojtje e tillë nga i pandehuri se këtë e ka bërë nën argumentimin e pas kalimit të afatit dy vjeçar, pëlqimi nga ana e AKP-së nuk është i nevojshëm, të rezultojnë që të jetë në kundërshtim me obligimet të parapara sipas kontratës për privatizim të kësaj ndërmarrjeje dhe se në këtë kohë ende nuk ishte liruar nga mbikëqyrja e AKP-së.

Ndërsa për pretendimi ankimor se është e pa qartë se si ka ardhur gjykata e shkallës së parë deri te shumën 5,400.000 euro, të cilat i akuzuari i ka sjellë vetës dobi pasurore kjo gjykata gjen se ky

konstatim të jetë paraqitur si tërësia e shumave të paraqitura nga blerja dhe investimet dhe kreditimet, e të paraqitura sipas faturave që kishte ndodhur dhe raportuar nga kompania F... sh.p.k në organet e AKM/AKP-së, edhe pse në aktgjykim theksohet se i ka sjellur dobi pasurore në vlerë rreth 5,400.000 euro, pra nga të dhënat e auditorëve të paraqitur si në shkresat e lëndës dhe se kjo shumë është përfaqësuar dhe përcaktuar, e në mungesë të një ekspertize financiare, mirëpo këtu kemi të bëjmë me dobi pasurore ashtu si parasheh dispozita e nenit 120 pika 34 të KPRK-së, e cila përcakton se çfarëdo pasurie e cila fitohet drejtpërdrejtë ose tërthorazi nga vepra penale, e që në rastin konkretë duke marrë parasysh se i akuzuari me paraqitje të investimeve fiktive e duke i sjellë në lajthim zyrtarët e AKM/AKP, ka arritur që të përfitoj për vete dobi pasurore e në dëm të ndërmarrjes shoqërore F... e përfaqësuar nga AKP-ja dhe në këtë mënyrë edhe buxhetin e shtetit, e që sipas dispozitës së nenit 120 pika 31 të KPRK-së, përcakton si dëm në shkallë të madhe prej më shumë se 50,000, e në rastin konkretë gjykata e shkallë së parë ka vepruar drejtë kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale të mashtrimit, në vazhdimësi, nga neni 261 par.2 të KPK-së, pasi që në këtë rast dëmi tejkalon shumën prej 15.000 euro.

Gjykata e Apelit gjen si të pabazuar pretendimin ankimor në drejtim të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale për dispozitivin III pika 3 të aktgjykimit fajshues, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në aktgjykimin e ankimuar ka dhënë arsye të mjaftueshme dhe të qarta për vërtetimin e faktit të shmangies së tatimit nga ana e të akuzuarit, për të cilat arsye edhe kjo gjykatë i pranon si të tilla, pasi që gjatë hetimeve në këtë çështje penale njësia e hetimeve tatimore të ATK-së nga raporti i aktiviteteve të NJHTS të realizuara për "F..." sh.p.k. për periudhën kohore nga viti 2006 deri në vitin 2010 këto investime në mjete themelore nuk janë pranua, te faturat e evidentuara janë konsideruar si fatura fiktive, pasi që nuk është ofruar dokumentacioni dhe informata shtesë që dokumentojnë prejardhjen e tyre.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e Gjykatës për shkelje të ligjit material.

Mbrojtësit e të akuzuarit A.D. në ankesë theksojnë se aktgjykimi dënues për të pandehurin A.D. është marrë në shkelje të dispozitave të ligjit material, respektivisht në kundërshtim me nenin 385 lidhur me par.1 pika 1.3 të KPPRK-së, ngase ekzistojnë rrethanat që përjashtojnë ndjekjen penale, për shkak të ndjekja penale është parashkruar, duke theksuar se gjykata thekson se periudha kohore gjatë së cilës pretendohet se është kryer vepra penale është nga 23.03.2006-20.01.2012 dhe atë në mënyrë të vazhdueshme, duke përshkruar dispozitën e nenit 81 nën par.1-5 të KPRK-së, duke shtuar se gjykata jo rastësisht nuk e ka cekur kohën e saktë të kryerjes së veprës penale, duke i konsideruar dy situata konkrete dhe atë se i pandehuri ka paraqitur fatura të rreme dhe fiktive për kontratën për ndërtim me kompaninë R... sh.p.k që ndërtimi nuk është realizua, edhe përkundër kësaj që i pandehuri e ka paraqitur si investim në AKP të njëjtën fatur dhe investim blerjen e rimorkio/kamion nga dëshmitari D.Z.. Mbrojtja më tutje thekson se veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale e cila konsiston në pretendimin se është paraqitur fatura e rreme me përshkrim "ndërtimi i depos në Podujevë" ka ndodhur me datën 01.06.2009. Ndërsa, veprimi tjetër i kryerjes së kësaj vepre penale e cila konsiston në pretendimin se janë paraqitur në mënyrë të rreme blerja e kamionit/ rimorkios, ka ndodhur me datën 26.04.2007, andaj sipas mbrojtjes duke marrë parasysh dispozitën e nenit 106 të KPK-së e lidhur me nenin 107 par.8 i KPK-së, ka arritur dyfishi i kohës së afatit për parashkrim(i cili është 5 vjet), andaj është arritur afati absolut i parashkrimit.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimi ankimor për shkelje të ligjit penal është i pabazuar, ngase duke marrë për bazë që pretendimi i mbrojtjes se datat e kryerjes së veprave penale nga ana e të akuzuarit A.D., në momentin e nënshkrimit të këtyre dy kontratave, respektivisht për shitblerjen e kamionit dhe rimorkios me datë 26.04.2007 dhe kontratës për ndërtimin e depos me datë 01.06.2009 është i

pabazuar për faktin se vepra penale e mashtrimit për të cilën është shpallur fajtor i akuzuari A.D. është veprë penale e cila është kryer në vazhdimësi, pra akuzuari veprën e parë të mashtrimit për paraqitje të faktit të rremë gjegjësisht kontratës së shitblerjes kamionit / rimorkios, me dëshmitarin D. Z. e cila mbanë datën 26.04.2007 e ka paraqitur pranë zyrtarëve të AKM/AKP në tremujorin e pestë gjegjësisht për periudhën kohore 01.04. deri me 30.06.2007, ndërsa veprën e dytë të mashtrimit në vazhdimësi për paraqitje të faktit të rrejshëm gjegjësisht kontratën në mes të “R...” sh.p.k dhe “F...” sh.p.k e cila mban datën 18 maj 2009 e që këtë investim e ka paraqitur pranë zyrtarëve të AKM/AKP si veprim i ndërmarrë në kryerje të veprës penale të mashtrimit nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, gjegjësisht veprimi i fundit inkriminues nga i akuzuari A.D., është pikërisht data e dorëzimit të konfirmimit të raportit të rregullt për investimet kapitale, gjë që në rastin konkret duke marrë parasysh se që nga veprimi i parë i ndërmarrë nga ana e të akuzuarit e deri në kohën kur i akuzuari i ka paraqitur këto fakte para organeve kompetente të AKM/AKP, është pikërisht veprimi i ndërmarrë gjegjësisht momenti i paraqitjes së këtyre fakteve të rreme – fiktive për pranim të investimeve me datë 06.04.2010, ndërsa datat për të cilat i referohet mbrojtja janë datat kur i akuzuari kishte kryer këto punë juridike-kontrata e të cilat i kishte siguruar me qëllim që ti përdorë para organeve të AKM/AKP-së për ti paraqitur si investime fiktive, andaj datat në të cilat i referohet mbrojtja si data të kryerjes së veprave penale, sipas kësaj Gjykate nuk janë data kur i akuzuari ka ndërmarrë veprimin e kryerjes së veprës penale të mashtrimit për të cilën është shpallur fajtor andaj, që nga kjo kohë duke marrë parasysh afatet ligjore për parashkrimin e kësaj veprë penale, gjegjësisht nenit 106 të KPK-së, ku parashihet që vepra penale për të cilën është paraparë me shumë se 3 vite burgim, afati i parashkrimit është 5 vite, e që parashkrimi absolut është dyfishi i kohës së paraparë së afatit për parashkrim dhe marrë parasysh se koha e kryerjes së veprës penale, gjegjësisht momenti kur i akuzuari ka ndërmarrë veprimin e fundit për të kryer veprën penale të mashtrimit nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, është data 06.04.2010, prandaj rrjedhimisht në këtë çështje penale nuk ka arritur afati i parashkrimit të ndjekjes penale dhe se gjykata e shkallës së parë ka vepruar drejtë kur të akuzuarin e ka shpallur fajtor për veprën penale të mashtrimit në vazhdimësi nga neni 261 par.2 lidhur me par.1 të KPK-së, meqenëse në veprimet e të akuzuarit fitohen të gjitha elementet e veprës penale të mashtrimit në vazhdimësi ku i akuzuari me anë të paraqitjes së fakteve të rreme apo duke fshehur faktet e me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete dhe për t'i shkaktuar dëm material tjetrit në vazhdimësi ka mashtruar dhe ka sjellur në lajthim zyrtarët e AKM/AKP-së, që të veprojnë në dëm të pasurisë së AKP-së, në atë mënyrë që i akuzuari gjatë periudhës kohore që nga data 23.03.2006 e deri me 20.01.2012, kur edhe ka arritur realizimin e qëllimeve të veta nëpërmjet mashtrimit të paraqitjes së fakteve të rrejshme, në atë mënyrë që AKP të pranojë këto investime fiktive dhe ndërmarrjen e re “F...” ta lirojë nga monitorimi i AKP-së dhe në kundërshtim me kushtet e marrëveshjes së zotimit, pasi që në këtë çështje penale nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, gjegjësisht nga dëshmitari D. Z. në shqyrtimin gjyqësor të dt. 16.02.2018 ka deklaruar se të akuzuarin A.D. e njehe meqenëse ka blerë mall prej tij dhe armaturë, e që pas ballafaqimit të deklaratës së tij të dhënë në polici me dt. 23 prill 2014 në faqen e 1 të rreshtit i 10 – të, në pyetjen e zyrtarit policor ka deklaruar se a e dini se çfarë mjeti keni kontaktuar mes “F...” dhe juve , ai është përgjigjur se “Me sa më kujtohet ka qenë në pyetje një kamion DAF i cili nuk ka qenë kurrë pronë reale e imja, mirëpo sa më kujtohet në vitin 2007 më ka thirr E. D. dhe më ka thënë të regjistrojë një kamion në emrin tim”. Nuk e di se në emër të kujt ka qenë ai kamion, por pasi e kanë regjistruar në emrin e tij në një kohë shumë të shkurtër prapë E. D. i ka thënë të bëjë një kontratë tjetër gjoja se po ia shes fabrikës “F...”. I njëjti ka deklaruar se qëndron pranë kësaj deklaratë të dhënë në polici, e për këtë veprim nuk ka pasur ndonjë qëllim të caktuar dhe me kompaninë “F...” ka nënshkruar dy kontrata, njëra ka qenë për kamion dhe tjetra për rimorkio e në pyetjen e Kryetarit të trupit gjykues se a i kujtohet se sa ka qenë vlera e kontratës është përgjigjur se vlera ka qenë 41.500 euro ndërsa vlera e rimorkios 29.500 euro. Po ashtu dëshmitari S. R... në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 30.03.2018 ka konfirmuar se

ka pasur një kontratë ndërmjet firmës “R...” e që është pronar dhe ndërmarrjes “F...” lidhur me një ndërtim, i cili këtë e ka kuptuar prej vëllait të tij E.R., i cili është menaxher e i cili ka njohuri lidhur me një kontratë në vlerë prej 326.570.00 euro me ndërmarrjen “F...”. Ndërsa, me deklaratën e dhënë në hetuesi në procesverbalin e dt. 23.04.2018 në faqen 2 të kësaj dëshmie është përgjigjur se fatura nuk është realizuar, nuk ka ndërtuar asnjë objekt, por kjo faturë është bërë me kërkesë të A.D.t dhe se për çfarë qëllimi është përdorur nuk ka njohuri dhe shuma e cekur në faturë nuk është e vërtetë dhe nuk ka pranuar kurrfarë pagese. Dëshmitari E.R. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 26.04.2018, ka deklaruar se në vitin 2009 ka punuar në firmën “R...” sh.p.k. dhe ka konfirmuar se ka pasur furnizim me material, armaturë për ndërtimin e objektit “F...” në lokacionin në të cilin gjendet dhe se ka pasur marrëveshje për ndërtimin e një depoje në objektin “F...”, në fillim ka qenë me ndërtu pasi që S. D. është vëllai i A.D.t, ka insistuar që të ndërtojë vet atë depo, mirëpo firma e tij ka siguruar materialin. Kontrata nuk është realizuar ashtu siç është nënshkruar, mirëpo vetëm materiali është dorëzuar. Në ballafaqimin me deklaratën e tij të dhënë në polici me dt. 08.12.2014 në faqen 5 në shqyrtimin gjyqësor ka konfirmuar se sasinë e materialit ku është ndërtuar depoja e biznesit “F...” sh.p.k., fatura tatimore e cila realisht është dashur që ti lëshohet biznesit “F...” në emër të furnizimit me materiale ndërtimor, duhej të ishte shumë e rreptë 42.000.00 euro, e jo vlera e faturës që është lëshuar në faturën nr. 3 të dt. 01.06.2009 ku është shuma prej 326.750.00 euro, duke thënë se deklaratën e ka dhënë me vullnet dhe pa presion, nuk i kujtohet se ka deklaruar kështu, ka harruar. Ndërsa, i njëjti ka deklaruar se në kontratat e lidhur në mes të “R...” sh.p.k. dhe “F...” sh.p.k, a keni qenë ju të obliguar që vetëm ta furnizoni me material apo ti kryeni punët ndërtimore, i njëjti është deklaruar se sipas kontratës kanë pasur për obligim edhe punën, ndërsa pasi që S. D. ka thënë që i kanë punëtorët e vet.

Pretendimet ankimore dhe gjetjet e gjykatës për vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Mbrojtja e të akuzuarit A.D. në ankesë thekson se gjykata duke i vlerësuar provat në mënyrë të gabuar ka bërë vërtetimin e gabuar të gjendjes faktike. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike konsiston posaçërisht në faktin se gjykata e trajton ndërtimin e depos dhe faturën e lëshuar nga R... sh.p.k si të paqenë dhe në këtë mënyrë e paraqet këtë faturë fiktive. Të gjitha provat dëshmojnë se ky objekt/depo është e ndërtuar. Njëjtë qëndron edhe situata lidhur me blerjen e kamionit dhe rimorkios nga ana e D. Z., në këtë rast vërtetimi i gabuar i gjendjes së fakteve konsiston në faktin se gjykata i trajton fiktive këto transaksionet, ndërsa që të gjitha provat dëshmojnë të kundërtën.

Gjykata e Apelit gjen si të pabazuara pretendimet ankimore të parashtruara nga mbrojtësit e të akuzuarit për vërtetimin e gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e gjendjes faktike i ka bazuar në provat materiale pra kontratat dhe fatura të cilat janë administruar dhe në shqyrtimin gjyqësor ndërsa nga dëgjimi i dëshmitarëve në rastin konkretë D.Z., S. R... dhe E.R., kanë dëshmuar në gjykatë se ato si dokumente janë përpiluar, por në realitet nuk kanë ndodhur pra, janë paraqitur si fiktive e të cilat i akuzuari A.D. i ka paraqitur si investimet kapitale pranë zyrtarëve të AKM/AKP-së, ndërsa mbrojtja pos që vetëm thekson se këto janë vlerësuar në mënyrë të gabuar nga ana e gjykatës e njëjta nuk ka paraqitur ndonjë provë e cila kishte për të dëshmuar të kundërtën e kësaj, edhe pse më sipër në aktgjykim është theksuar se nuk është kontestues ekzistimi i depos, kamionit dhe rimorkios, por ato me fatura janë paraqitur me vlera joreale pra të rreme dhe fiktive, pra ndërtimi i depos nuk ishte bërë nga kompania që ishte kontraktuar nga vetë i akuzuari në emër dhe interes të ndërmarrjes dhe që rimorkio dhe kamioni nuk ishin blerë fare nga dëshmitari kinse në cilësinë e shitësit, e të cilët si të tillë pra janë paraqitur si investime kapitale pranë AKM/AKP-së.

Gjykata e Apelit pas analizimit dhe vlerësimit të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë ka gjetur se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë, pasi që gjatë shqyrtimit gjyqësor gjykata e shkallës së parë pos provave dhe dëshmime të dëshmitarëve të tjerë, aktgjykimin e ka bazuar në bazë të deklaratës së dëshmitarit D. Z., i cili gjatë shqyrtimit gjyqësor ka vërtetuar faktin e ekzistimit dhe të nënshkrimit të kontratave për shitblerje të këtij kamioni / rimorkios, për të cilat në realitet nuk kanë ndodhur dhe i cili në shqyrtimin gjyqësor të dt. 16.02.2018 ka deklaruar se të akuzuarin A.D. e nje meqenëse ka blerë mall prej tij dhe armaturë, e që pas ballafaqimit të deklaratës së tij të dhënë në polici me dt. 23 prill 2014 në faqen e 1 të rreshtit i 10 – të, në pyetjen e zyrtarit policor ka deklaruar se a e dini se çfarë mjeti keni kontaktuar mes “F...” dhe juve , ai është përgjigjur se “Me sa më kujtohet ka qenë në pyetje një kamion DAF i cili nuk ka qenë kurrë pronë reale e imja, mirëpo sa më kujtohet në vitin 2007 më ka thirr E. D. dhe më ka thënë të regjistrojë një kamion në emrin tim”. Nuk e di se në emër të kujt ka qenë ai kamion, por pasi e kanë regjistruar në emrin e tij në një kohë shumë të shkurtër prapë E. D. i ka thënë të bëjë një kontratë tjetër gjoja se po ia shes fabrikës “F...”. I njëjti ka deklaruar se qëndron pranë kësaj deklarate të dhënë në polici, e për këtë veprim nuk ka pasur ndonjë qëllim të caktuar dhe me kompaninë “F...” ka nënshkruar dy kontrata, njëra ka qenë për kamion dhe tjetra për rimorkio e në pyetjen e Kryetarit të trupit gjykues se a i kujtohet se sa ka qenë vlera e kontratës është përgjigjur se vlera ka qenë 41.500 euro ndërsa vlera e rimorkios 29.500 euro. Po ashtu, kjo deklaratë e tij mbështetet dhe vërtetohet edhe me provat materiale, gjegjësisht kontratat dhe faturat të cilat janë administruar në shqyrtimin gjyqësor, po ashtu kjo gjendje faktike është vërtetuar edhe nga dëshmia e dëshmitarëve S. R..., i cili në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 30.03.2018 ka konfirmuar se ka pasur një kontratë ndërmjet firmës “R...” e që është pronar dhe ndërmarrjes “F...” lidhur me një ndërtim, i cili këtë e ka kuptuar prej vëllait të tij E.R., i cili është menaxher e i cili ka njohuri lidhur me një kontratë në vlerë prej 326.570.00 euro me ndërmarrjen “F...”. Ndërsa, me deklaratën e dhënë në hetuesi në procesverbalin e dt. 23.04.2018 në faqen 2 të kësaj dëshmie është përgjigjur se fatura nuk është realizuar, nuk ka ndërtuar asnjë objekt, por kjo faturë është bërë me kërkesë të A.D.t dhe se për çfarë qëllimi është përdorur nuk ka njohuri dhe shuma e cekur në faturë nuk është e vërtetë dhe nuk ka pranuar kurrfarë pagese. Ndërsa, dëshmitari E.R. në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt. 26.04.2018, ka deklaruar se në vitin 2009 ka punuar në firmën “R...” sh.p.k. dhe ka konfirmuar se ka pasur furnizim me material, armaturë për ndërtimin e objektit “F...” në lokacionin në të cilin gjendet dhe se ka pasur marrëveshje për ndërtimin e një depoje në objektin “F...”, në fillim ka qenë me ndërtu pasi që S. D. është vëllai i A.D.t, ka insistuar që të ndërtojë vet atë depo, mirëpo firma e tij ka siguruar materialin. Kontrata nuk është realizuar ashtu siç është nënshkruar, mirëpo vetëm materiali është dorëzuar. Në ballafaqimin me deklaratën e tij të dhënë në polici me dt. 08.12.2014 në faqen 5 në shqyrtimin gjyqësor ka konfirmuar se sasinë e materialit ku është ndërtuar depoja e biznesit “F...” sh.p.k., fatura tatimore e cila realisht është dashur që ti lëshohet biznesit “F...” në emër të furnizimit me materialë ndërtimor, duhej të ishte shumë e rreptë 42.000.00 euro, e jo vlera e faturës që është lëshuar në faturën nr. 3 të dt. 01.06.2009 ku është shuma prej 326.750.00 euro, duke thënë se deklaratën e ka dhënë me vullnet dhe pa presion, nuk i kujtohet se ka deklaruar kështu, ka harruar. Ndërsa, i njëjti ka deklaruar se në kontratat e lidhur në mes të “R...” sh.p.k. dhe “F...” sh.p.k, a keni qenë ju të obliguar që vetëm ta furnizoni me material apo ti kryeni punët ndërtimore, i njëjti është deklaruar se sipas kontratës kanë pasur për obligim edhe punën, ndërsa pasi që S. D. ka thënë që i kanë punëtorët e vet. Këto dëshmi, janë vërtetuar edhe me provat materiale të kontratës së ndërtimit të lidhur ndërmjet “R...” sh.p.k dhe “F...” sh.p.k – i akuzuari A.D. që mban datën 18 maj 2009, e që është pjesë e shkresave të lëndës.

Nga raporti i auditorit të pavarur G... i datës 17 Qershor 2009, për Ndër.e Re F... sh.p.k Podujevë, për periudhën prej 24 mars 2006 e deri më 23 mars 2008, pjesë e shkresave të lëndës, vërtetohet se investimet kapitale në shumën prej 3,367.500 që janë bërë jashtë ambienteve të Kompanisë dhe jo në

lidhje me biznesin kryesor të kompanisë, gjë që nuk është në përputhshmëri me paragrafin 2 të Marrëveshjes së Zotimit që specifikon se kompania do të investoj një minimum prej 2,800,000 euro te investime kapitale në biznesin dhe pajisjet e kompanisë, dhe se ky auditor konstaton se deri më datën e këtij raportimi nuk ishin në gjendje të sigurohemi me procedurat e konfirmimit zë zbatuara me furnitorët e kompanisë për investimet si kërkohet në kushtet e përgjithshme.

Nga raporti i auditorit N.SH.T "T..." Gjilan, datës 07.10. 2010, për periudhën Prill 2008- Shtator 2010, pjesë e shkresave të lëndës, rezulton të jetë bërë ekspertiza mbi vlerën reale të automjeteve dhe makinave punuese të sh.p.k F... ku nga ky raport rezulton të jetë vërtetuar për mospërputhjet e investimeve kapitale me vlera të paargumentuara me dokumentacion përkatës dhe çmimeve të fryra, ashtu si më saktësisht jepet në sqarimet e fusnotave në këtë raport si dhe sa i përket zotimit për punësim nga ky raport rrjedh se janë prezantuar pagat e paguara ashtu si edhe tatimet dhe kontributet e papaguara, duke vërejtur nga auditori se nga lista e nënshkrimeve shihet se punëtorët nuk punojnë në orarin e plotë por vetëm në gjysmë orar në shumicën e kohës. Ndërsa nga raporti i po të njëjtit auditor për periudhën Shtator 2010- Maj 2011, në sqarimin 3 rezulton se nga të gjeturat shihet një mos përputhje e lartë në mes këtyre vlerave. Derisa investimet e bëra sipas investitorit që nga fillimi e gjerë më 20 Qershor 2011 kapin shumë prej gjithsej 6,130,945.42 euro, ato të gjetur nga verifikimet e auditorëve janë vetëm 1,807.900.00euro. Kjo tregon që investitori bën mbivlerësimin e investimeve të bëra për mes dokumentacioneve të parregullta e të paqena. Investimet e bëra kryesisht janë investime në riparime të objekteve apo dhe në blerjen e automjeteve transportuese apo vetura të udhëtarëve, por jo edhe në rritje të kapacitetit prodhues apo modernizim të këtyre kapaciteteve. E sa i përket zotimit të punësimeve në këtë raport në sqarimin 4 rezulton të jetë konstatuar se investitori nuk e ka përmbushur zotimin për të punësuarit as në aspektin kuantitativ dhe as në atë kualitativ ngase numri i tyre nga muaji në muaj ka pësuar rrënje për të përfunduar në 67 punëtor gjatë muajit maj 2011. Madje edhe ky numër nuk paraqet të punësuarit real pasi që për disa muaj rresht të punësuarit kanë punuar vetëm nga disa ditë në muaj. Tatimi në paga dhe kontribute pensionale nuk janë paguar me rregull, të njëjtat janë paguar vetëm pas rivlerësimeve të ATK-së, për gatë muajit Prill 2011.

Nga raporti i ATK-së- Njësia e hetimeve tatimore dhe inteligjencës me nr.Prot.06/2015 datë 12.01.2015 dhe NJHTI nr.prot.1067/14 të datës 14.10.2014 rezulton se Sh.p.k. F... ka bërë shmangie tatimore të cilat janë konstatuar gjatë kontrolleve për këtë ndërmarrje me ç 'rast ka përfitur paligjshëm dhe ka dëmtuar Buxhetin e R. të Kosovës.

Sa i përket gjendjes faktike për veprën penale të legalizimit të përmbajtjes së rremë, në vazhdimësi, nga neni 403 par. 2 lidhur me par.1 të KPRK-së, kjo Gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar gabimisht gjendja faktike duke konsideruar se i akuzuari ka paraqitur fatura fiktive private dhe si të tilla nuk janë dokumente publike. Mirëpo, duke marr parasysh objektin mbrojtës të kësaj vepre penale gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të administruara është dashur të vërtetoj gjendjen e fakteve se këto fatura fiktive a janë regjistruar në regjistrin publik të AKM/AKP- dhe se me të njëjtat a i ka vënë në lajthim zyrtarët e AKM/AKP e të cilat fatura kanë pasur rol vendimtar për të shërbyer në komunikimin juridik në raport me organin e AKM/AKP që të shërbejnë si dokumente të legalizuara me përmbajtje të rreme e që si të tilla ti kenë shërbyer të akuzuarit për të realizuar një të drejtë në procesin e përmbjlljes së mbikëqyrjes dhe përmbushjes së detyrimeve sipas kontratës për privatizim të ndërmarrjes F...sh.p.k në raport me AKP-ën.

Pretendimi ankimor dhe gjetjet e gjykatës lidhur me vendimin mbi sanksionin penal.

Edhe pse Prokurorja e PSRK-së, me ankesë cek edhe bazën ankimore për shkak të vendimit mbi dënimin e njëjta në ankesë nuk jap asnjë pretendim, pra nuk thekson asgjë, ndërsa mbrojtja e të

akuzuarit në këtë drejtim nuk ka ushtruar ankesë, andaj kjo gjykatë gjen se në rastin konkret nuk kemi ankesë mbi vendimin mbi dënimin.

Në rigjykim gjykata e shkallës së parë duhet të vërtetoj për secilin të akuzuar se në cilësinë e personit zyrtar e në kuadër të punëve dhe detyrat e punës bazuar në emërimet gjegjësisht kontratat e punës për secilin të akuzuar, cilat veprimet i kanë ndërmarrë gjegjësisht nuk i kanë ndërmarrë e të cilat ishin në kundërshtim me detyrat dhe përgjegjësit sipas Ligjit nr. 04/L-034 për AKP-në dhe legjislacionit përcjellës, e më pas ti vlerësoj këto veprime në kuptim të veprës penale për të cilën akuzohen sipas aktakuzës së PSRK-së. Ndërsa në raport me veprën penal të legalizimit të rremë nga neni 403 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së, gjykata e shkallës së parë duhet të vërtetoj se a ishin këto fatura fiktive të regjistruara në regjistrin e AKM/AKP-ës, dhe a ishin këto fatura fiktive me rol vendimtarë që kanë shërbyer në komunikimin juridik për zyrtarët e AKM/AKP-së për të liruar nga monitorimi dhe përmbushja e detyrimeve nga AKM/AKP-ja apo si të tilla nga zyrtarët e AKM/AKP-së kanë qenë si dokumente të cilat ju kanë nënshtruar kontrollit dhe vlerësimit nga zyrtarët përkatës të AKM/AKP-së, para se të paraqiten në komunikim juridik për realizimin e të drejtës në procedurën para zyrtarëve të AKM/AKP-së për tu liruar nga monitorimi dhe obligimeve sipas kontratës së privatizimit ndërmjet AKM/AKP-së dhe F... sh.p.k.

Sa i përket propozimit të konfiskimit gjykata e shkallës së parë duhet të vlerësoj provat në tërësi lidhur me konfiskimin e këtyre asetëve sipas urdhrin ndalues afatgjatë, duke mos u kufizuar në çështjet civile-përmbarimore të cilat janë vendosur nga gjykata tjera në procedurë civile meqenëse kjo duhet të vlerësohet në aspektin penale lidhur me përfitimin e kësaj dobie pasurore.

Nga arsyet e sipër cekura aktgjykimi i ankimuar përkitazi me të akuzuarit N.O., B.SH., SH.LL., N.A., M.Y., A.K. dhe A.D. juridikisht është i paqëndrueshëm dhe si i tillë është dashtë të anulohet dhe çështja t'i kthehet Gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Në rigjykim Gjykata e shkallës së parë duhet të veprojë në pajtim me vërejtjet e lartcekura, t'i eliminoj të gjitha shkeljet e cekura, t'i administroj të gjitha provat, dhe të njëjtat t'i vlerësojë në pajtim me dispozitën e nenit 370 të KPPRK-së, dhe varësisht nga rezultati i vlerësimit të provave të nxjerr konkluzione të drejta të ligjshme e të bazuara në provat e administruara e mandej të marrë vendim të drejtë dhe ligjor.

Nga arsyet e lartcekura u vendos si në dispozitave të këtij aktgjykimi konform nenit 401 dhe 402 të KPPRK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

DEPARTAMENTI SPECIAL

APS.nr.2/2019 më datë 30.12.2019

Procesmbajtës

Anëtarët e kolegjit

Kryetari i kolegjit

Leonita Lajçi

Vaton Durguti

Ferit Osmani

Milan Bigoviq

